


Këto udhëzime janë të vlefshme për të gjithë Pastruesit Dentarë KENDA që përdoren për punime riparuese dhe parandaluese.

Pastruesit për përdorim të një pacienti, përmbajnë etiketën  dhe nuk duhet të përdoren më shumë se një herë, duke qenë se përdorimi më shumë se një herë i këtyre pastruesve mund të shkaktojë rreziqe të panevojshme të pacienti dhe personeli.

Përbërja: Pastruesit përbëhen nga gomë sintetike/silikoni, pigmente dhe lëndë gërryese. Trupi i tyre është prej inoksi ose plastike mjekësore.

Indikacioni: Pastruesit Dentarë KENDA përdoren për të pastruar materiale të ndryshme që specifkohet në etiketën e ambalazhimit.

Kundër-indikacionet: Nëse njihet se pacienti është alergjik ndaj njërit prej përbërësve të mësipërm, pastruesit nuk duhet të përdoren.

Efektet negative: Nuk njihen deri tani.

Këshilla të përgjithshme sigurie:



Mos tejkaloni shpejtësinë maksimale



Përdorni mbrojtje për frymëmarrjen



Përdorni mbrojtje për sytë



Përdorni spërkatje me ujë minimumi 50 ml/min

Masat e sigurisë:

- Produktet mund të përdoren vetëm në fushën e specifikuar të përdorimit.
- Kontrolloni bashkimin e sigurt të pastruesit përpara se ta përdorni atë dhe bëni një provë fillimisht.
- Përdorni vetëm pjesë mbajtëse të rregullt dhe hiqni menjëherë çdo pastrues të dëmtuar, të shtrembëruar ose që nuk lëviz më në mënyrë centrike.
- Shmangni trysinë e tepruar që mund të shkaktojë anim, përkulje apo bllokim të pastruesit.
- Ftohja e pamjaftueshme me ujë mund të rezultojë në dëmtime të riparueshme në dhëmb dhe indet rrethuese.
- Përdorimi i dezinfektuesit të gabuar dhe/ose kohëzgjatja e tepruar e dezinfektimit mund të shkaktojë depërtim në pastrues ose çngjyrosje të tij. Prandaj, sigurohuni që efikasiteti i dezinfektuesit të jetë i miratuar dhe i përshtatshëm për pastruesit, mos përdorni dezinfektues që përmbajnë aldehide dhe ndiqni udhëzimet në produkt të dhëna nga prodhuesi në lidhje me përqendrimin dhe kohën e reagimit. Sigurohuni që procesi të jetë efikas.
- Gjithmonë ruani numrat e ngarkesës së pastruesve (Lot Number) për të siguruar gjurmimin e tyre.

Ruajtja: Rekomandohet një vend ruajtjeje i thatë dhe pa ndryshk në temperaturë 2 deri 28°C (36 deri 82°F). Kushtet e papërshtatshme të ruajtjes mund të shkurtojnë jetëgjatësinë e produktit dhe mund të shkaktojnë keqfunksionim të tij.

Udhëzime për higjienën: Ju lutemi referojuni sërish kësaj faqeje për udhëzime të detajuara mbi higjienën.

alb version shqiptar
 ara النسخة العربية
 bul българска версия
 chi 中國版
 cze Česká verze
 dan danske version
 dut Nederlandse
 eng english version
 est Eesti versioon
 fin Suomalainen versio
 fre Version française
 ger deutsche Version
 gre Ελληνική έκδοση
 heb גרסה עברית
 hrv hrvatska verzija
 hun magyar változat
 ice Íslensk útgáfa
 ita Versione italiana

ind Bahasa Indonesia versi
 jpn 日本語版
 kor 한국어 버전
 lav Latviešu valodā
 lit Lietuviška versija
 mac македонска верзија
 nor Norsk versjon
 per نسخه فارسی
 pol Polska wersja
 por Versão em português
 rum Versiunea romana
 rus Русская версия
 slo slovenská razlīca
 slv slovenska razlīčica
 spa Versión en español
 swe Svensk version
 tur Türkçe versiyonu
 ukr Українська версія



QR-Code
<http://knd.li/ins>

Këto udhëzime higjienë janë të vlefshme për të gjithë Pastruesit Dentarë KENDA për përdorim në klinika dentare.

PARALAJMËRIME:

Pastruesit KENDA furnizohen të pastertilizuar dhe për këtë arsye duhet të trajtohen përpara përdorimit.

Pastruesit për përdorim të një pacient (të etiketuara me ) nuk mund të ripërdoren, por duhet të dezinfektohen dhe sterilizohen përpara përdorimit të tyre të vetëm.

Gjatë përpunimit të të gjithë pastruesve, duhen mbajtur veshur gjatë gjithë kohës veshje mbrojtëse, dorashka dhe syze mbrojtëse.

Mos përdorni banjë për freza.

Kufizimi i ripërpunimit: Jetëgjatësia e produktit përcaktohet nga konsumimi i instrumentit pastrues. Përpunimi i përsëritur ka efekt minimal të këta instrumente.

Pika e përdorimit: Hiqni kontaminimin sipërfaqësor me një pecetë njëpërdorimëshe menjëherë pas përdorimit të pacienti dhe vendoseni në një enë.

Mbajtja dhe transportimi: Pastruesit duhet të transportohen menjëherë në një tabaka të mbyllur për instrumente deri në zonën e trajtimit. Vazhdoni menjëherë me pastrimin dhe dezinfektimin.

Pastrimi dhe dezinfektimi: Vazhdoni me trajtim me aparat (rekomandohet) ose trajtim manual.

a. Trajtimi me aparat:

1. Shpëlajeni plotësisht me ujë të rrjedhshëm.
2. Pastroni pastruesit në pajisjen larëse/dezinfektuese dhe sigurohuni që të mos prekin njëri-tjetrin.
3. Shtoni agjentin e përshtatshëm të pastrimit (pa përmbajtje aldehide), sipas informacionit në etiketën e produktit dhe udhëzimeve të prodhuesit të pajisjes larëse/dezinfektuese.
4. Nisni programin e dëshiruar: pastrim dhe dezinfektim.
5. Pas përfundimit të programit, nxirrni pastruesit nga pajisja larëse/dezinfektuese dhe thajini, preferimisht me ajër të pastër të kompresuar.
6. Kontrolloni me sy pastërtinë dhe tërësinë duke përdorur një xham zmadhues me zmadhim 6 herë. Në rast ndotjeje të dukshme, procesi duhet të përsëritet.
7. Nëse kryhet vetëm pastrim mekanik (pa dezinfektim të vërtetuar) kërkohet një dezinfektim përfundimtar në një sterilizues me avull (të paambalazhuar) në tabaka ose rafte të përshtatshme.
8. Të merret miratimi i dokumentuar i procedurës së rregullt të trajtimit për ripërdorimin ose për ruajtjen.
9. Rekomandohet një vend ruajtjeje i thatë, pa ndryshk në temperaturë 2 deri 28°C (36 deri 82°F).

b. Trajtimi manual:

1. Shpëlajeni plotësisht me ujë të rrjedhshëm. Nëse është e nevojshme, përdorni furçë najloni. SHËNIM: Përdorni një furçë të përshtatshme për pastrimin e vrimave që nuk kanë dalje.
2. Pastroni dhe dezinfektoni kimikisht me një solucion të përshtatshëm (pa përmbajtje aldehide) sipas udhëzimeve të prodhuesit. Fusni pastruesin brenda në solucion. Sigurohuni që pastruesit të mos kenë fluska ajri.
3. Koha e reaksionit fillon me futjen e pastruesit të fundit dhe zgjat sipas udhëzimeve të prodhuesit të dezinfektuesit.
4. Pasi mbaron koha e kontaktit, shpëlajini pastruesit me shumë ujë të dejonizuar.
5. Thani lagështirën e mbetur preferimisht me ajër të pastër të kompresuar.
6. Kontrolloni me sy pastërtinë dhe tërësinë duke përdorur një xham zmadhues me zmadhim 6 herë. Në rast ndotjeje të dukshme, procesi duhet të përsëritet.
7. Pa dezinfektim të vërtetuar, kërkohet një dezinfektim përfundimtar në një sterilizues avulli (të paambalazhuar) në tabaka ose rafte të përshtatshme.
8. Të merret miratimi i dokumentuar i procedurës së rregullt të trajtimit për ripërdorimin ose për ruajtjen.
9. Rekomandohet një vend ruajtjeje i thatë, pa ndryshk në temperaturë 2 deri 28°C (36 deri 82°F).

Sterilizimi: Sterilizim me nxehtësi me lagështi me prevakuim fraksionues. Cikël i plotë, 134°C (273°F) / 3,1 bar për të paktën 5 minuta, koha e tharjes 10 minuta. Mos tejkaloni 135°C (275°F).



E RËNDËSISHME: Përdorni ambalazh të përshtatshëm për sterilizim.

Paralajmërim: Pastruesit Dentarë KENDA nuk janë të përshtatshëm për sterilizim me ajër të nxehtë ose kemiklavë.

Kjo procedurë është vërtetuar nga një laborator i pavarur dhe i akredituar.

Informacion shtesë: Kur sterilizohen disa instrumente në një cikël në autoklavë sigurohuni që të mos tejkalohet ngarkesa maksimale e sterilizuesit, në përputhje me udhëzimet e sterilizuesit.

Kontakti me prodhuesin:



KENDA AG
Kanalstrasse 18
LI-9490 Vaduz, Liechtenstein

Data e përgatitjes: 11/2013; Rishik. 2

Udhëzimet e dhëna më lart janë vërtetuar nga prodhuesi i pajisjes mjekësore si të afta për të përgatitur Pastruesit Dentarë KENDA për ripërdorim.

Materialet janë zhvilluar vetëm për përdorim në stomatologji. Përpunimi duhet të kryhet rreptësisht duke ndjekur "Udhëzimet për higjienën". Nuk pranohet përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga mosrespektimi i udhëzimeve ose zonës së përcaktuar të aplikimit. Përdoruesi është përgjegjës për testimin e produkteve për përshtatshmërinë dhe përdorimin e tyre për qëllimet e tjera që nuk përcaktohen shprehimisht të udhëzimet. Përkrahjet dhe të dhënat nuk përbëjnë asnjë garanci për vetitë dhe nuk janë detyruese.

Mbajeni në një vend ku nuk arrihet nga fëmijët.

Vetëm për përdorim stomatologjik.

Rx only.

CE
0120